

**Ligji Nr. 04/L-009  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2002/ 5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT  
TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2002/ 5 PËR THEMELIMIN E  
REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME**

**Neni 1**

Ky ligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme.

**Neni 2**

Neni 1. i ligjit bazik, paragrafi 1.3. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

1.3. AKK-ja me akt nënligjor përcakton nivelin e pagesave për shërbimet e ofruara për regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtshme në përputhje me koston e kryerjes së shërbimeve.

**Neni 3**

1. Neni 2. i ligjit bazik, paragrafi 2.2 pika d) ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

d). të drejtat e shfrytëzimit të pronave komunale, publike, shoqërore dhe pronave shtetërore.

2. Neni 2. i ligjit bazik, paragrafi 2.2 pas pikës d) shtohet pikë e re e) si vijon:

e). barrat dhe ngarkesat pronësore.

**Neni 4**

Neni 3. i ligjit bazik, paragrafi 3.7. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

3.7. Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistrohen në bazë të:

a). vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës;

b). vendimit të organit administrativ shtetëror;

c). kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent;

- d). vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit;
- e). vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit;
- f). vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe
- g). dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

#### **Neni 5 Zbatimi**

Neni 8 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Ministria kompetente e planifikimit hapësinor, në afat prej gjashtë (6) muajsh nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-009  
21 korrik 2011**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-011-2011, datë 03.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës  
Atifete Jahjaga.**